



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 May 2023
Nr. Ref.:2177/23

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI204/22

Parashtrues

Ismet Islami, përfaqësues i pretenduar i Fatmir dhe Shpejtim Behramit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit Pml.nr.117/2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës
të 6 qershorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani , kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatmir Behrami, në emër të të birit të tij Shpejtim Behrami (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përmes të cilës është specifikuar se përfaqësohet nga Ismet Islami (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml.nr.117/2018] të 6 qershorit 2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.382/2017] të 14 shtatorit 2017 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata e Apelit), dhe Aktgjykimin [PKR.nr. 213/2014] të datës 28 prill 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të kontestuar, përmes të cilit përfaqësuesi i pretenduar pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 dhjetor 2022, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 30 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.KSH.KI204/22] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 25 janar 2023, Gjykata e njoftoi z. Fatmir Behramin për regjistrimin e kërkesës dhe bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) dhe nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës kërkoi nga ai që të plotësojë kërkesën me dokumentet dhe informatat si në vijim:
 - (i) të dorëzojë informacione sqaruese nëse ai është vetë në cilësinë e parashtruesit të kërkesës apo parashtrues është Shpejtim Behramit, i cili paraqitet si palë në procedurën penale para gjykatave të rregullta; dhe
 - (ii) në rast të përfaqësimit nga përfaqësuesi ligjor, të dorëzojnë autorizimin e vlefshëm për përfaqësim në Gjykatë.
8. Nga dosja e lëndës rezulton që më 9 shkurt 2023, avokati Ismet Islami pranoi shkresën e Gjykatës, së 25 janarit 2023. Megjithatë, Gjykata brenda afatit të përcaktuar në shkresën e saj nuk ka pranuar saktësimin dhe kompletimin e kërkesës ashtu siç është kërkuar më shkresën e Gjykatës, të 25 janarit 2023.
9. Më 27 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtë.

1. 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës konteston Aktgjykimin [Pml.nr.117/2018] e 6 qershorit 2018 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
11. Nga shkresat e lëndës, rezulton se më 28 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR.nr. 213/2014] Shpejtim Behramin [të birit e parashtruesit të kërkesës] e shpalli fajtor për veprën penale “vrasje e rëndë” nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e pesë (25) vitesh, në të cilin dënim i ishte llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 29 maji 2014 e tutje.
12. Në një datë të pasaktësuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit ankesë paraqitën, z. Shpejtim Behrami, pala e dëmtuar si dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë.
13. Më 14 shtator 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.382/2017] refuzoi si të pabazuara ankesat z. Shpejtim Behrami, palës së dëmtuar si dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, respektivisht.
14. Në datë të pasaktësuar, kundër këtyre Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe atij të Gjykatës së Apelit, z. Shpejtim Behrami në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
15. Më 6 qershor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.117/2018]: (i) miratoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me llogaritjen e paraburgimit, duke e ndryshuar Aktgjykimin [PKR.nr.213/2014] e 28 prillit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimin [PAKR.nr.382/2017] e 14 shtatorit 2017, të Gjykatës së Apelit: dhe (ii) refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Pml.nr.117/2018] i kontestuar i 6 qershorit 2018, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
17. Parashtruesi i kërkesës, në emër të të birit të tij, Shpejtim Behrami kërkon nga Gjykata *“kthim në gjendje të mëparshme sipas nenit 50 [të Ligjit] që pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtroj kërkesën brenda afatit të përcaktuar, me arsyetimin se ka qenë i burgosur dhe nuk ka qenë në dijeni”*.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Rregullorja e punës

Rregulli 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

2) *Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

(c) *autorizimin për përfaqësuesin ligjor;*

(...)

(3) *Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm.*

Rregulli 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

(5) *Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtin nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
19. Megjithatë, përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse përfaqësuesi i pretenduar i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se: (i) neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar; si dhe (ii) neni 21 i Ligjit i cili përcakton që palët para Gjykatës përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala. Për me tepër, rregulli 32 i Rregullores së punës përcakton që kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
20. Në rastet kur kërkesat para Gjykatës nuk janë të kompletuara, bazuar në paragrafin 4 të nenit 22 të Ligjit, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Atëherë, kur palët përkatëse, nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë, bazuar në rregullin 35 (Tërheqja,

hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, duke marrë parasysh që kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të saj ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë të njëjtën.

21. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që kërkesa e dorëzuar në Gjykatë më 20 dhjetor 2022, ishte e paplotë, përkatësisht: (i) nuk ishte saktësuar nëse parashtruesi i kërkesës, z. Fatmir Behrami është autorizuar që të përfaqësojë para Gjykatës të birin e tij Shpejtim Behramit, ndaj të cilit ishte zhvilluara procedura penale; dhe (ii) mungonte autorizimi që dëshmon se Shpejtim Behrami në procedurë para Gjykatës e përfaqëson Ismet Islami. Si rezultat i kësaj, Gjykata, më 25 janar 2023, kërkoi nga z. Fatmir Behrami që të saktësojë kërkesën e me informatat dhe dokumentacionin si më lart.
22. Bazuar në dosjen e lëndës rezulton që më 9 shkurt 2023, avokati Ismet Islami kishte pranuar shkresën e Gjykatës, të 25 janarit 2023. Megjithatë, Gjykata sikurse nga z. Ismet Islami si dhe parashtruesi i kërkesës, brenda afatit të përcaktuar më shkresë nuk ka pranuar saktësimin dhe kompletimin e kërkesës ashtu siç u kërkua nga Gjykata.
23. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson, se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është e paplotë, sepse z. Fatmir Behrami dhe Ismet Islami, si përfaqësues të pretenduar të Shpejtim Behramit, përkundër kërkesës së Gjykatës, nuk kanë saktësuar kërkesën e parashtruar në Gjykatë si dhe nuk kanë dorëzuar autorizimet e vlefshme për përfaqësimin e palës të cilin, ata pretendojnë se e përfaqësojnë (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, KI25/21, parashtrues, *Ymer Koro*, si përfaqësues i pretenduar i K.Lj. dhe K.B., Vendim për refuzim të kërkesës, i 21 korrikut 2021; dhe KI137/20, parashtrues, *Naser Peci*, si përfaqësues i pretenduar i S.B., Vendim për refuzim të kërkesës, i 17 dhjetorit 2020).
24. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mungesës së autorizimit formal për përfaqësim, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (2) (c) dhe (3) dhe 35 (5) të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (2) (a) dhe (c) dhe (3) dhe 35 (5) të Rregullores së punës, më 27 prill 2023, njëzëri.

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani